

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Kam nëntë fëmijë"/ Telegrami i gruas së Abaz Kupit drejtuar kryeministrit Shefqet Vërlaci: Mos na internoni për qëndrimet e tim shoqi
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/kam-nente-femije-telegrami-i-gruas-se-abaz-kupit-drejtuar-kryeministr-i104340
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 05:27:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 05:24:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e3e9415f388370b3bbbe3e51db32b2664b2f0971eb4a0e662d6a8d4aa808183c
TEKSTI	b99d082435c85b8467b449287b7c810ed11047cd78b028affa72f4fec552e7ad
PAMJA	fa6d2d6d6f7d64f8c37a6bab0f88227865f2587b2159d1afc0e8ac46f772b854

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	691e3b024f8782995de42ec2c87cdb72c0dbef8b2e967ef46c6251a382d28677
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6d9560e9dee7d667e4c0855efa59278dec1e8935faed252449ae9de5f9970896
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/691e3b024f8782995de42ec2c87cdb72c0dbef8b2e967ef46c6251a382d28677>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash:

mbulojne
kostot
operative

2025, tite
ritje të
aftësisë
në

po
shkojnë
nën

privat. Disa
shkolla
private, në

pune ashtu
edhe në
dashuri

probleme të
njëpasnjëshme.
Do
zhgënjehet

mbi 33
miliardë
dollarë

Donald
Trump se
SHBA-të
nuk


kriminel

Bal
ish

AKTUALITET

“Kam nëntë fëmijë”/ Telegrami i gruas së Abaz Kupit drejtuar kryeministrit Shefqet Vërlaci: Mos na internoni për qëndrimet e tim shoqi

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 07:24



Në verën e vitit 1939, vetëm pak muaj pas pushtimit italian të Shqipërisë, Hava Kupi, bashkëshortja e Abaz Kupit, i drejtohej me një telegram kryeministrit Shefqet Vërlaci. Kërkesa e saj ishte dramatike: të mos internohej së bashku me nëntë fëmijët dhe pjesëtarët e tjerë të familjes.

Telegrami, i nisur nga Kruja dhe i regjistruar nga administrata e kohës, dëshmon ankhin e një gruaje që rrezikonte të dënohej bashkë me fëmijët për shkak të qëndrimit politik dhe veprimtarisë së bashkëshortit.

Në dokument, Hava Kupi shpjegon se, pas vendosjes së regjimit të ri, ishte larguar drejt Jugosllavisë së bashku me Abaz Kupin. Më pas ajo kishte vendosur të kthehej në Shqipëri, por sapo ishte rikthyer kishte mësuar se familjen e priste internimi.

“Me pritjen e regjimit të tashëm, me burrin t’em Abaz Kupin kam dalë në Jugosllavi”, shkruan ajo në telegram, duke iu drejtuar drejtpërdrejt kreut të qeverisë së vendosur pas pushtimit italian.

Hava Kupi kërkonte që fati i saj dhe i fëmijëve të mos lidhej me atë të Abaz Kupit. Ajo theksonte se ndodhej në një gjendje të rëndë familjare dhe se kishte nën kujdes nëntë fëmijë, ndaj i lutej Vërlacit të ndërhynte për të ndaluar internimin.

“Ju lutem të mëshironi gjendjen t’ime familjare”, lexohet në pjesën përmbyllëse të telegramit, të firmosur prej saj.

Dokumenti daton në ditët e fundit të korrikut dhe fillimin e gushtit 1939, ndërsa në të shfaqen disa vula dhe shënime të ndryshme administrative. Telegrami mban gjurmët e përcjelljes dhe regjistrimit nga strukturat shtetërore, çka tregon se kërkesa kishte mbërritur në zyrën e kryeministrit Shefqet Vërlaci.

Vetëm disa muaj më parë, më 7 prill 1939, Abaz Kupi kishte qenë një nga ushtarakët që organizuan qëndresën në Durrës kundër zbarkimit të forcave italiane. Pas pushtimit, ai u largua nga Shqipëria, ndërsa familja e tij mbeti nën presionin dhe ndëshkimin e autoriteteve të reja.

Shefqet Vërlaci ishte vendosur në krye të qeverisë që pasoi pushtimin dhe kishte luajtur rol qendror në procesin politik që e lidhi Shqipërinë me kurorën italiane. Pikërisht atij i kërkonte mëshirë bashkëshortja e njeriut që kishte kundërshtuar me armë pushtimin.

Telegrami i Hava Kupit nuk është thjesht një shkresë administrative. Ai është dëshmia e një kohe kur përndjekja politike nuk kufizohej të kundërshtari, por shtrihej mbi gruan, fëmijët dhe të gjithë familjen e tij. Pas rreshtave të shkruar me dorë qëndron drama e një nëne me nëntë fëmijë, e detyruar t’i lutej qeverisë së pushtimit që të mos i dënonte për zgjedhjet politike të të atit.

Historia do të tregonte se vuajtjet e familjes Kupi nuk do të përfundonin me regjimin fashist. Pas ardhjes së komunistëve në pushtet, familjarët e Abaz Kupit do të përballeshin sërish me burgje dhe internime. Kështu, telegrami i vitit 1939 mbetet paralajmërimi i hershëm i një kalvari që do ta ndiqte familjen për dekada.

Artikui te sugjeruar

AKTUALITET 16 Shtator07:20

Ujësjetellësit përmiërësojnë financat, por 53% e shoqërive nuk mbulojnë kostot operative

Sektori i ujësjetellës-kanalizimeve ka përmiërësuar treguesit financiarë gjatë vitit 2025, me rritje të aftësisë p&e...

AKTUALITET 15 Shtator23:42

Shkatërrohet banda e shqiptarëve, dyshohet për të paktën 40 grabitje në banesa

Katër shqiptarë janë arrestuar në Itali, pasi dyshohen se janë pjesë e një grupi kriminal që ka kryer të paktë...

AKTUALITET 15 Shtator21:07

Trafiku i drogës në Shqipëri? DASH: Organizatat e krimit kanë lidhje me kartelet

Drejhtësia shqiptare ishte një nga çështjet e trajtuara në Kongresin amerikan. Joe Wilson ngriti shqetësime mbi korrupsionin, kri...

AKTUALITET 15 Shtator20:50

Sekuestrohen 20 kg drogë në Austri, dy të arrestuar, mes tyre një shqiptar

Policia austriake ka arrestuar dy persona të dyshuar për trafik droge në Vjenë, një 32-vjeçar austriak dhe një 37-vje&ccedi...

AKTUALITET 15 Shtator20:10

“Me ç’fytirë pushtetit i ngjitesh?”/ Protestuesit ironizojnë Ramën me pankarta në ditën e 108-të

Protesta e 108-të kundër qeverisë së Edi Ramës është shoqëruar edhe këtë herë me pankarta me mesazhe iron...

AKTUALITET 15 Shtator19:43

Rama paralajmëroi masa për ndërhyrje në punësime, rasti i dajës së Zegjine Çaushit ngre pikëpyetje: A do të veprojë kryeministri?

Vetëm një javë më parë, në kuadër të “Pranisë Besnike”, kryeministri Edi Rama u përcolli deputet&e...

AKTUALITET 15 Shtator19:17

“Nuk jam ndjerë i shantazhuar, s’kam rrjete sociale”. gjyqtari Engert Pëllumbi i përgjigjet deputëtëve. Manja: Paske rënë rehat

Kryetari i Shoqatës së Gjyqtarëve dhe gjyqtar në Apelin e Gjykatës së Posaçme, Engert Pëllumbi u është p&eum...

AKTUALITET 15 Shtator18:48

Lirimi i Parkut të Liqenit nga ndërtimet pa leje, Bashkia e Tiranës aksion për prishjen e godinës shumëkatëshe

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Bashkisë së Tiranës ka prishur sot një objekt katërkatësh pa leje në zonën...

AKTUALITET 15 Shtator18:46

Policia rrugore shoqëron kamionët e “Alesio-2014” në orarin e ndalimit të qarkullimit

Një situatë skandaloze është fotografuar pasditen e kësaj të marte, (15 shtator 2026) në zonën e Unazës së Vog...

AKTUALITET 15 Shtator18:21

Zjarr i përmasave të mëdha në fshatin “Andon Poçi” në Gjirokastrë, zjarrfikësit vënë nën kontroll flakët

Një zjarr ka përfshirë pasditen e sotme një sipërfaqe me shkurre dhe kallamishte në hyrje të fshatit Andon Poçi, n&eum...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 15 Shtator

Sulmohet Arabia Saudite, bombardohet me raketa ...

Huthët e Jemenit, të mbështetur nga Irani, kanë nisur një valë të re sulmesh ndaj Arabisë Saudite, ndërsa paralel...

AKTUALITET 15 Shtator

Rrëfihet 34-vjeçarja: Daja i Zegjine Caushit më...

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak ditë më parë në Roskovec, ku Bledar Bakaj shkoi në shtëpinë e ish-bashk&e...

AKTUALITET 15 Shtator

[Gjykata e Lartë merr vendimin për kreun e Bashk...](#)


Gjykata e Lartë shqyrtoi sot rigjykimin e çështjes që lidhet me masën e sigurisë ndaj kryebashkiakut të Tiranës, Eri...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV






Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.